



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1169/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI101/17

Parashtrues

Nesim Cena

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0030, të 27
korrikut 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nesim Cena nga Rahoveci (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Ismet Kërçagu, avokat nga Rahoveci.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I-14-0030, të 27 korrikut 2017.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi në kërkesë nuk specifikon se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur me aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 gusht 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 28 gusht 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Kolegjit të Apelit.
8. Më 23 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune me Ndërmarrjen Shoqërore "Silosi" (në tekstin e mëtejme: NSH "Silosi").
10. Më 19 nëntor 1991, menaxhmenti i NSH "Silosi", mori Vendimin nr. 278, me të cilin parashtruesit të kërkesës ia ndërpreu marrëdhënien e punës.
11. Më 16 nëntor 2005, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Bordi i Drejtorëve të AKP-së) mori vendimin, se më 17 nëntor 2005 ta fillojë procesin e likuidimit të NSH "Silosi". Në vendimin për likuidim theksohet "[...] të gjitha palët e interesuara kanë afatin për të dorëzuar kërkesat e tyre pronësore në Komisionin e Likuidimit të DSH "Silosi" deri më 26 shkurt 2006."

12. Më 25 janar 2008 (pas skadimit të afatit ligjor), parashtruesi paraqiti kërkesën e tij pronësore në Komisionin e Likuidimit të NSH "Silosi", me arsyetimin "*... se është vonuar pak në paraqitjen e kërkesës, sepse nuk dinte që kërkesën e tij duhej t'ia dorëzonte Komisionit të Likuidimit*".
13. Më 14 shkurt 2013, Autoriteti i Likuidimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Autoriteti i Likuidimit i AKP-së), nxori Vendimin nr. PRZ004-0397, me të cilin kërkesën pronësore të parashtruesit e refuzoi si të pabazuar për arsye "*se është paraqit jashtë afatit kohor në të cilin palët kanë pasur mundësi të paraqesin kërkesat e tyre pronësore.*"
14. Më 7 mars 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), kundër Vendimit nr. PRZ004-0397 të Bordit të AKP-së për likuidimin.
15. Parashtruesi i kërkesës në ankesë, ndër të tjera, theksoi: "*se kërkesën e ka parashtruar më vonë se për shkak se nuk ka pasur dijeni për se duhet me iu drejtuar organeve për kompenzimin e pagave të papaguara.*"
16. Më 31 korrik 2013, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së u përgjigj ndaj ankesës së parashtruesit dhe i propozoi gjykatës që ta refuzojë ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar me arsyetimin "*se ankesa është e pabazuar, kërkesa është e parashkruar, ngase është parashtruar pas afatit të përcaktuar për parashtrimin e kërkesave.*"
17. Ankesën e parashtruesit dhe përgjigjen e AKP-së, Dhoma e Posaçme ia dërgoi Kolegjit të Specializuar nr. IV të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) për vendimmarrje.
18. Më 15 janar 2014, Kolegji i Specializuar mori Aktgjykimin C-IV-13-0102, me të cilin ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar, me arsyetimin:

"Ankuesi (parashtruesi) në ankesë por as në përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes të parashtruar më vonë nuk ka sjellur dëshmi të besueshme që do ta justifikonin vonesën e tij kaq të gjatë në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit.

Neni 37 paragrafi 4 pika 4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të paafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi."

19. Më 7 mars 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit.
20. Autoriteti i Likuidimit të AKP-së gjithashtu dërgoi përgjigjet e veta në Kolegjin e Apelit, ku ndër të tjera, theksoi "*se afati kishte përfunduar më 26 shkurt 2006. Prandaj kërkesa e tij do të ishte e paafatshme.*"

21. Më 27 korrik 2017, Kolegji i Apelit mori Aktgjykimin AC-I-14-0030 me të cilin ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

“Kolegji vërtetoi se likuidimi i ndërmarrjes NSH “Silosi” Xërxë filloi më 17 nëntor 2005 në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 16 nëntor 2005. Afati për parashtrimin e kërkesave pranë Komisionit të Likuidimit përfundoi më 26 shkurt 2006. Ankuesi e parashtroi kërkesën e tij më 25 janar 2008 siç shihet nga vula e AKM-së. [...] Nga ajo që u tha më lart, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“është e vërtetë se pak është vonuar në paraqitjen e të njëjtës kërkesë; por siç kemi dhënë sqarim së pari nuk ka pasur kurrfarë dijenie se duhet me iu drejtuar organit për kërkesën e kompensimit për rrogat të pamarruna, nuk lexon shtyp; është vozitës nuk merret me politikë.”*
23. Parashtruesi më tej thekson se ligjvënësi lidhur me vonesën për rastet siç është rasti i tij ka paraparë edhe lehtësimin, kështu që në nenin 380, paragrafi 2 dhe nenin 193 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, tolerohet vonesa deri në pesë vjet. Kjo kërkesë e tij duhet që në mënyrë analoge të lidhet me këto nene.
24. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *“që të marrë parasysh thëniet në kërkesë dhe ta aprovoj të njëjtën kërkesë dhe t'i bëhet pagesa e 161 pagave të pa marruna të cilat kapin shumën prej 80.0498.-€.”*

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113. [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
27. Gjykata në rastin konkret vëren se parashtruesi nuk ka specifikuar në kërkesën e tij se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur me vendimet e gjykatave të rregullta, dhe nëse është paraparë me nenin 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës]:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

28. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatet e përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
30. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”

31. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës ankohet për drejtësinë e procedurës gjyqësore lidhur me refuzimin e ankesës së tij për kërkesën pronësore të paraqitur Komisionit për likuidim të NSH “Silosi”.
32. Prandaj, Gjykata do të merret me shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit në bazë të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
33. Sa i përket nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, Gjykata, para së gjithash, rikujton jurisprudencën e saj, ku ka përcaktuar:

“Sipas Kushtetutës, nuk është detyra e saj të veprojë si Gjykatë e Apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet e gjykatave më të ulëta. Roli i gjykatave më të ulëta është të interpretojë ligjin dhe të zbatojë rregullat përkatëse të procedurës dhe të drejtës materiale (shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur një gjykim të drejtë (shih, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i 23 qershorit 2010, Korporata Energjetike e Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të

Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, paragrafët 66 dhe 67).” (Shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të 18 tetorit 2010, *Karfeta kundër Gjykatës Supreme*, KI42/09, para. 18, 19).”

34. Gjykata gjithashtu rikujton që në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
35. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka përcaktuar që *“roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale”* (shih: GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28). ”.
36. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës si argument kryesor për shkeljet e pretenduara kushtetuese thekson faktin se *“gjykatat është dashur t’i zbatojnë dispozitat ligjore të nenit 380, paragrafi 2 dhe nenit 193 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që rregullojnë afatet e ndryshme kohore të parashkrimit”*.
37. Pikërisht për sa i përket pretendimeve të parashtuesit të kërkesës, Gjykata rikujton arsyetimin e GJEDNJ-së në rastin *Andelković kundër Serbisë* (Aktgjykimi i 9 prillit 2013, numër 1401/08, paragrafi 24).

“Gjykata në fillim, rikujton se detyra e saj nuk është që të marrë rolin e gjykatave vendase. Para së gjithash, autoritetet vendase, në veçanti gjykatat, duhet t’i zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit vendor (shih: Aktgjykimin e GJEDNJ, Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 31). Në këtë rast, Gjykata nuk do të ngrejë pyetje të interpretimit të ligjit vendor nga gjykatat vendase, përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm (shih, mutatis mutandis, Adamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, paragrafi 118, 24 qershor 2008), me fjalë të tjera, kur vëren se zbatimi i ligjit nga gjykatat vendase në raste të caktuara, është qartazi i gabuar ose janë marrë konkluzione arbitrare dhe/ose u mohohet drejtësia (shih, mutatis mutandis, Farbers dhe Harlanova kundër Lituanisë (vendimi), numër 57313/00, 6 shtator 2001, dhe megjithëse në kontekstin e nenit 1 të Protokollit 1, Beyeler kundër Italisë [DHM], numër 33202/96, paragrafi 108, GJEDNJ 2000-I).”

38. Në bazë të kësaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për zbatimin e gabuar dhe interpretimin jokonsistent të dispozitave përkatëse ligjore, që pretendohet të janë bërë nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit, ngre çështje që bien në fushëveprimin e gjykatave të rregullta (ligjshmëria) dhe jo në fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese (kushtetutshmëria).
39. Për më tepër, Gjykata konstaton se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit në aktgjykimet e tyre kanë zbatuar dispozitat ligjore të nenit 37, paragrafi 4, pika 4.1 e Aneksit të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me të cilat rregullohen pikërisht afatet kohore të parashkrimit të kërkesës.

Neni 37, paragrafi 4, pika 4.1

[...]

4.1. kërkesat që konsiderohen të jenë të paafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi.”

40. Gjykata më tej vëren se Kolegji i Apelit në aktgjykimin e tij AC-I-14-0030 gjithashtu i është përgjigjur pretendimeve ankimore të parashtruesit lidhur me zbatimin e nenit 380, paragrafi 2 dhe të nenit 193 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe pse kjo dispozitë ligjore nuk është zbatuar në rastin konkret, gjë që kjo Gjykatë e konsideron të bazuar dhe të arsyetuar.

“Neni 35.3 i Shtojcës parasheh që Komisioni i Likuidimit me diskrecionin e vet mund të vendosë të pranojë dëshminë e kërkesës apo interesit të dorëzuar pas afatit për parashtrimin e kërkesave, nëse dëshmia e kërkesës apo interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave. Në rastin në fjalë ankuesi ka dorëzuar parashtruesin e tij për afërsisht 23 muaj pas afatit. Prandaj, neni 35.3 i Shtojcës nuk mund të zbatohet. Pasi që neni 35,3 i Shtojcës është ligji më specifik për çështjen në fjalë, neni 380.2 i Ligjit për Detyrimet nuk është i aplikueshëm.”

41. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi nuk tregon se procedurat para gjykatave të rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të arrinte në përfundimin se thelbi i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur ose se parashtruesit i është shkelur ndonjë garanci procedurale, e cila do të çonte në shkelje të kësaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës ose nenit 6 të KEDNJ-së.
42. Për më tepër, sa i përket shkeljes së nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata në bazë të konkludimeve të gjykatave të rregullta si dhe bazuar në vet pretendimet e parashtruesit të kërkesës vëren se vetë parashtruesi e ka humbur mundësinë për të tentuar t'i realizojë të drejtat e tij pronësore, përkatësisht t'i realizojë të drejtat e tij për të ardhurat e papaguara që ai konsideron se ka të drejtë, duke mos paraqitur kërkesën e tij pronësore brenda afatit të organet kompetente, e që gjykatat e rregullta kanë konkluduar në aktgjykimet e tyre.
43. Duke pasur parasysh këtë që u tha më sipër, Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit kanë dhënë argumente të qarta dhe të sakta për të mbështetur të gjitha gjetjet dhe përfundimet e tyre. Prandaj, Gjykata nuk mund ta vlerësojë procedurën në gjykatat e rregullta si arbitrare.

44. Gjkata konsideron se është obligim i parashtruesit që t'i mbështes pretendimet e tij kushtetuese dhe t'i paraqes dëshmitë *prima facie* që tregojnë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në pajtim me juridiksionin e Gjykatës (shih: Rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
45. Megjithatë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe as nuk ka treguar se ka pasur shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.
46. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutën dhe KEDNJ.
47. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 tetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi